



REGIONAL  
ANTI-CORRUPTION  
INITIATIVE

With funding from

 Austrian  
Development  
Cooperation

# Udhëzuesi i CRA me listat e kontrollit mbi Sektorin e Arsimit të Lartë

Botuesi: Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit  
Fra Andjela Zvizdovica 1, B/14, 71 000 Sarajevo, Bosnjë-Hercegovinë  
Tel: +387 33 296 321, Faks: +387 33 296 329, Email: [info@rai-see.org](mailto:info@rai-see.org)  
Faqja e internetit: [www.rai-see.org](http://www.rai-see.org)

Autorët: Prospector Ltd  
Jovan Nicić  
Miloš Mojsilović  
Ana Arsenijević Momčilović  
Roman Prah

Për botuesin: Desislava Gotskova - Drejtoresha e Sekretariatit të RAI-t  
Redaktor: Aneta Arnaudovska - Këshilltar i Lartë për Antikorrupsion  
Përkthimi: We translate Albania

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument u takojnë autorëve dhe nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtarë të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit, ose të shteteve të saj anëtare, dhe të Agjencisë Austriake për Zhvillim

**Maj, 2022**

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>4</b>
<b>2</b>	<b>Udhëzues për CRA në Sektorin e Arsimit të Lartë .....</b>	<b>6</b>
	<b>2.1.</b> Qqëllimi i Udhëzuesit – pse është e rëndësishme të vlerësohen rreziqet e korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe si mund t'i reduktojë përdorimi i listave të kontrollit këto rreziqe?.....	<b>6</b>
	<b>2.2.</b> Përkufizimi i "Sektorit të Arsimit të Lartë" .....	<b>8</b>
	<b>2.3.</b> Përkufizimi i "korrupsionit", "rreziqeve të korrupsionit", "faktorëve të rrezikut të korrupsionit" dhe "vlerësimit të rrezikut të korrupsionit" .....	<b>8</b>
	<b>2.4.</b> Standardet dhe praktiket ndërkombëtare .....	<b>10</b>
	<b>2.5.</b> Konteksti i Sektorit të Arsimit të Lartë në perspektivat rajonale - praktiket e mira dhe fushat për përmirësim .....	<b>12</b>
	<b>2.6.</b> Si të zbatoni Udhëzuesin me listat e kontrollit në nivelin e juridiksioneve kombëtare? .....	<b>20</b>
<b>3</b>	<b>Listat e kontrollit .....</b>	<b>21</b>

## Udhëzuesi i CRA me listat e kontrollit mbi Sektorin e Arsimit të Lartë

### 1. Hyrje

Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) zbaton një projekt trevjeçar të quajtur Evropa Juglindore - Së bashku kundër Korrupsionit (SEE-TAC).<sup>1</sup> Veprimtaritë e projektit, ndër të tjera, përfshijnë zhvillimin e udhëzuesit me listat e kontrollit për analizat sektoriale të Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit për dy sektorët e identifikuar të prirur ndaj korrupsionit dhe veprimtaritë shoqëruese kombëtare dhe rajonale të ngritjes të kapaciteteve (ushtrime trajnimi të përshtatura bazuar në udhëzuesin e sektorit të zhvilluar me mjetet e listave të kontrollit në dy sektorë të përbashkët të prirur ndaj korrupsionit për të gjitha juridiksionet e synuara).<sup>2</sup> Për nevojat e përgatitjes së veprimtarive të projektit drejt hartëzimit kombëtar dhe rajonal të sektorëve që duhet të jenë subjekt i ndërhyrjeve, Sekretariati i RAI dhe Ekipi i Ekspertëve të Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit kanë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- **Sondazhi gjithëpërfshirës** - Metoda e parë e zbatuar ishte studimi dytësor i bazuar në rishikimin e dokumenteve më të rëndësishme kombëtare kundër korrupsionit (strategjitë, planet e veprimit, politikat, sondazhet e organizatave përkatëse ndërkombëtare të pranishme në vend dhe OSHC të përfshira në luftën kundër korrupsionit). Konteksti rajonal u studiuua përmes rishikimit të konstatimeve dhe rekomandimeve nga raportet përkatëse të mekanizmave të monitorimit kundër korrupsionit dhe integritetit (Komisioni Evropian, GRECO, Cikli i Rishikimit të UNCAC) dhe rezultatet nga sondazhet rajonale dhe ndërkombëtare të perceptimit të korrupsionit (Barometri Ballkanik, Indekset e Perceptimit të Korrupsionit të TI, Barometri Global i TI, etj). Metoda e dytë e zbatuar ishte pyetësori i cili përfshinte pyetje mbi zonat e prirura ndaj korrupsionit në juridiksionet e synuara për të përcaktuar këndvështrimin e përfituesve dhe komentet e nevojshme për hartëzimin e sektorëve me interes të përbashkët të prirur ndaj korrupsionit.
- **Përcaktimi i kriterëve kryesorë për hartëzimin e sektorëve të përbashkët** nga perspektiva e veprimtarive të mëtejshme të projektit në fushën e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit (CRA) dhe Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion (CPL) në juridiksionet e synuara.
- **Organizimi i takimeve dhe konsultimeve dypalëshe me përfaqësues të institucioneve publike përkatëse nga juridiksionet e synuara.** Qëllimi kryesor i këtyre takimeve ishte prezantimi i Projektit të RAI, qasje e cila do të përdoret, dhe identifikimi i sektorëve që duhet të jenë objekt i ndërhyrjeve në fushën e CRA dhe CPL në juridiksionet përkatëse.

Pas këtyre hapave, në një takim rajonal të mbajtur në korrik 2021, përfaqësuesit e të gjitha juridiksioneve të synuara dhe juridiksioneve të tjera të synuara nga projekti SEE-TAC ranë dakord që **Sektori i Arsimit të Lartë është një nga sektorët e prirur ndaj korrupsionit me**

<sup>1</sup> Më shumë detaje janë të disponueshme në <https://rai-see.org/what-we-do/see-tac/>

<sup>2</sup> Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Mali i Zi, dhe Maqedonia e Veriut. Këto juridiksione janë synuar në bazë të fazës së mëparshme të projektit dhe kanë shprehur interesin e përfituesve dhe përfaqësuesve të vendeve anëtare të Grupit Drejtues të RAI

**interes të përbashkët dhe se ky sektor duhet të jetë subjekt i Udhëzuesit të veçantë të CRA me listat e kontrollit.<sup>3</sup>**

### **Metodologjitë e kërkimit dhe struktura e Udhëzuesit**

Metoda kryesore e kërkimit për këtë veprimtari ishte analiza dytësore e kuadrit dhe praktikës legislative, institucionale dhe organizative për Sektorin e Arsimit të Lartë në pesë juridiksione të synuara, duke përfshirë të dhënat e disponueshme mbi parimin e barazisë gjinore (p.sh. raportet dhe sondazhet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare të disponueshme për korrupsionin dhe rreziqet e korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë në juridiksionet e synuara, dokumentet dhe politikat kryesore kundër korrupsionit për Sektorin e Arsimit të Lartë të juridiksioneve të synuara, modelet e planit të integritetit për Sektorin e Arsimit të Lartë dhe dokumente të tjera të paraqitura nga aktorët nga katër juridiksione të synuara).

Për të marrë informacion shtesë për identifikimin e objektivave dhe specifikave të përgjithshme sektoriale, dhe për të përcaktuar fushat/proceset e përbashkëta të rrezikut të korrupsionit dhe rreziqet e korrupsionit dhe faktorët e rrezikut të korrupsionit në këto fusha/procese, Ekipi i Ekspertëve të CRA përgatiti pyetësin për aktorët nga juridiksionet e synuara.<sup>4</sup> Pyetësit iu përgjigjën 12 përfaqësues të aktorëve. Përgjigjet dhe qëndrimet e tyre përfaqësuan një bazë të vlefshme për zhvillimin e këtij dokumenti të cilat u përfshinë në tekst.

Objektivi kryesor i Udhëzuesit është të ndihmojë juridiksionet kombëtare në identifikimin dhe reduktimin e rreziqeve të korrupsionit dhe faktorëve të rrezikut të korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë.

Dokumenti përmban dy komponentë kryesorë: a) Udhëzuesi për CRA në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe b) Listat e kontrollit për katër fusha/procese të përbashkëta të prirura ndaj korrupsionit në sektorët e arsimit të lartë të juridiksioneve të synuara. Në seksionin e parë, dokumenti trajton qëllimin e Udhëzuesit; përcaktimin e termave më të rëndësishëm; standardet ndërkombëtare në fushën e CRA dhe praktika në fushën e CRA për Sektorin e Arsimit të Lartë, dhe konteksti i këtij sektori në perspektivat rajonale. Seksioni i dytë paraqet përmbledhjen e katër fushave të zakonshme të prirura ndaj korrupsionit dhe proceseve më të cenueshme brenda këtyre fushave në sektorët e arsimit të lartë të juridiksioneve të synuara me rreziqe të përbashkëta të identifikuara të korrupsionit dhe pyetje kontrolli që lidhen me përcaktimin e masave për reduktimin e rreziqeve të përshkruara.

---

<sup>3</sup> <https://rai-see.org/rai-secretariat-organized-regional-meeting-on-mapping-sectors-prone-to-corruption/>

<sup>4</sup> Autoritetet kombëtare kundër korrupsionit dhe institucionet kompetente të Sektorit të Arsimit të Lartë nga juridiksionet e synuara.

## 2. Udhëzues për CRA në Sektorin e Arsimit të Lartë

**2.1. Qëllimi i Udhëzuesit – pse është e rëndësishme të vlerësohen rreziqet e korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe si mund t'i reduktojë përdorimi i listave të kontrollit këto rreziqe?**

Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit është i nevojshëm për funksionimin afatgjatë të suksesshëm të pjesëve të ndryshme të sektorëve të prirur ndaj korrupsionit. Nëse rreziqet e korrupsionit nuk menaxhohen, ato herët a vonë do ta ekspozojnë institucionin ose procesin ndaj mundësisë që nëpunësit/punonjësit të përfshihen në sjellje korruptive ose joetike. Nëse ndodh një ngjarje korrupsioni ose shkelje e integritetit, pasojat afatshkurtra dhe afatgjata për një institucion ose sektor të caktuar përfshijnë humbjen e reputacionit, humbjen e besimit të publikut, humbjen direkte financiare, burimet e humbura, koston e drejtësisë penale ose të sistemit të auditimit për t'iu përgjigjur korrupsionit, efektet negative në stafin tjetër dhe ndikimin negativ në moralin e institucioneve.<sup>5</sup> Duke pasur parasysh këtë, vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit, veçanërisht në sektorët e prirur ndaj korrupsionit është një mjet i rëndësishëm me përfitime të shumta: a) përfshin në agjendë çështjet e parandalimit të korrupsionit, integritetit dhe qeverisjes së mirë dhe përparon sipas një qasjeje të pastër ligjore; b) mundëson identifikimin e rreziqeve të përbashkëta (për shembull, përmes regjistrit të centralizuar për rreziqet) në një sektor të caktuar që kërkon veprim, reformë legjislative ose reformë më të gjerë institucionale/kombëtare; c) mundëson shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira për identifikimin e rrezikut dhe, në veçanti, për masat për zbutjen e rrezikut brenda një sektori të caktuar ose ndërmjet sektorëve, institucioneve ose proceseve; d) mundëson shkëmbim efektiv të praktikave të mira dhe/ose krijimin e regjistrit të centralizuar për rreziqet e korrupsionit që shërben si burim frymëzimi, idesh dhe mbështetjeje nga kolegët për reformën dhe qeverisjen e mirë në sektorin konkret. Për të arritur këto qëllime, çdo qasje ndaj vlerësimit të rrezikut të korrupsionit duhet të fokusohet në analizimin e proceseve dhe procedurave në jetën reale në institucion, sektor apo projekt. Përveç se është mjet i menaxhimit proaktiv të rrezikut të korrupsionit, vlerësimi i rrezikut të korrupsionit mund të ndihmojë në: forcimin e koherencës, cilësinë e qeverisjes dhe menaxhimit në një institucion ose sektor të caktuar të sektorit publik; duke mundësuar vlerësimin e rrjedhës së punës dhe proceseve dhe identifikimin e pikave të dobëta për reforma të mëtejshme institucionale, të menaxhimit dhe ligjore; dhe përmirësimin e mjedisit institucional dhe ligjor në një sektor të caktuar.<sup>6</sup>

**Korrupsioni në sektorin e lartë është një problem arsimor global në rritje me implikime të rënda për shoqëritë.**<sup>7</sup> Universitetet në vendet në zhvillim përballen me sfida unike që lindin nga liberalizimi i fundit dhe zgjerimi i shpejtë pasues i nën-sektorit. Korrupsioni në Sektorin e Arsimit të Lartë shkatërron reputacionin e universiteteve, bllokoi aksesin për aplikantët që përmbushin kërkesat dhe shpërdoron paratë e shpenzuara për studentët që nuk janë të aftë për të përmbushur detyrimet. Gjithashtu, korrupsioni mund të kërcënojë shëndetin, sigurinë

<sup>5</sup> Shih Ljiljana Selinšek, Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe – Comparative Research and Methodology, Sarajevo: Regional Cooperation Council, 2015, i disponueshëm në: [https://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA\\_in\\_public\\_ins\\_in\\_SEE-WEB\\_final.pdf](https://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA_in_public_ins_in_SEE-WEB_final.pdf)

<sup>6</sup> *Ibid*

<sup>7</sup> <https://www.u4.no/publications/corruption-in-universities-paths-to-integrity-in-the-higher-education-subsector.pdf>

dhe mirëqenien publike kur të diplomuarve të pakualifikuar dhe të paaftë në fushat profesionale u besohet ndërtimi, praktika mjekësore dhe funksione të tjera.<sup>8</sup>

**Të gjitha juridiksionet e synuara identifikuan Arsimin e Lartë si një nga sektorët e prirur ndaj korrupsionit.** Në të gjitha juridiksionet e synuara, fusha/procese të përbashkëta të prirura ndaj korrupsionit mund të identifikohen për këtë nivel arsimimi (p.sh. akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programet e tyre, sigurimi i cilësisë dhe kontrolli i punës së institucioneve të arsimit të lartë, provimet e studentëve; punësimi dhe promovimi i stafit të mësuesve).<sup>9</sup>

**Sektorin e Arsimit të Lartë në të gjitha juridiksionet e synuara përmban një rreth të gjerë institucionesh që zbatojnë politikën arsimore (universitete, fakultete, institute shkencore, organe për akreditimin dhe sigurimin e cilësisë, etj.). Gjithashtu, në të gjitha juridiksionet, institucionet e arsimit të lartë kanë një nivel të lartë të shpallur të autonomisë dhe kompetencës për të vetërregulluar shumë çështje.** Ky fakt paraqet një sfidë të rëndësishme lidhur me identifikimin e njëtrajtshëm të rreziqeve dhe faktorëve të rrezikut të korrupsionit, si rrjedhim edhe me formulimin e masave përgjithësisht të zbatueshme për zbutjen e tyre. Megjithatë, kjo sfidë mund të trajtohet nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit në koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë aktorëve përkatës në Sektorin e Arsimit të Lartë në juridiksione dhe përdorimit të rregullt të mjeteve të disponueshme të CRA, duke përfshirë këtë dokument.

**Në vijim të rëndësisë së vlerësimit të rreziqeve të korrupsionit, ky dokument synon të përshkruajë fushat e përbashkëta të prirura ndaj korrupsionit dhe proceset më të cenueshme brenda këtyre fushave në sektorët e arsimit të lartë të juridiksioneve të synuara, rreziqet e zakonshme të identifikuar të korrupsionit dhe pyetjet e kontrollit që lidhen me përcaktimin e masave për zbutjen e rreziqeve të përshkruara.** Me fjalë të tjera, ky dokument ofron një përmbledhje të rreziqeve më të përhapura të korrupsionit dhe faktorëve të rrezikut në Sektorin e Arsimit të Lartë brenda fushave/proceseve të përbashkëta të prirura ndaj korrupsionit të juridiksioneve të synuara, si dhe pyetjet kryesore që lidhen me zbutjen efikase të këtyre rreziqeve. Listat e kontrollit mund të ofrojnë vetëm një grup bazë pyetjesh me drejtimin që duhet të ndiqni. Pyetjet duhet tu përshtaten rrethanave specifike dhe duhet të kryhet shqyrtimi i kujdesshëm i të gjitha detajeve në legjislacion dhe praktikë në çdo juridiksion të vetëm që lidhet me secilën çështje.

Duke pasur parasysh këtë, Udhëzuesi u dedikohet kryesisht aktorëve që marrin pjesë në përgatitjen dhe miratimin e politikave dhe rregulloreve publike përkatëse për Sektorin e Arsimit të Lartë, duke përfshirë politikën dhe rregullat kundër korrupsionit - ministritë kompetente, organet kundër korrupsionit, këshillat për arsimin e lartë, organet për akreditim dhe sigurimin e cilësisë dhe universitetet. Për shembull, kur është e zbatueshme, institucionet kundër korrupsionit mund të përdorin lista kontrolli për përgatitjen e modeleve të planit të integritetit për institucionet e arsimit të lartë. Përveç kësaj, institucionet e veçanta të arsimit të lartë (për shembull fakultetet) mund të përdorin lista kontrolli për të vlerësuar politikën dhe praktikën e tyre të brendshme, si dhe përputhshmërinë e tyre me veprimtarinë për menaxhimin e rreziqeve të korrupsionit të identifikuar nga kjo ndërhyrje. Në perspektiva krahasuese dhe rajonale, zbatimi i udhëzuesit me listat e kontrollit mund të ofrojë përgjigje

---

<sup>8</sup> *Ibid*

<sup>9</sup> <https://rai-see.org/rai-secretariat-organized-regional-meeting-on-mapping-sectors-prone-to-corruption/>

të vlefshme për ngjashmëritë dhe dallimet në juridiksione të ndryshme në trajtimin e korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe përfaqëson bazën për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në këtë drejtim.

## **2.2. Përkufizimi i "Sektorit të Arsimit të Lartë"**

Përdorimi i termit "Arsimi i Lartë" në këtë raport është i barabartë me termin "arsim terciar", siç përcaktohet në klasifikimin ISCED 2011 (Instituti i Statistikave i UNESCO, 2021). Arsimi terciar bazohet në arsimin e mesëm, duke ofruar veprimtari mësimore në fusha të specializuara të arsimit. Synon të mësuarit në një nivel të lartë kompleksiteti dhe specializimi. Arsimi terciar përfshin atë që zakonisht kuptohet si arsimi akademik, por gjithashtu përfshin arsimin e avancuar profesional. Kjo përfshin ciklin e shkurtër të arsimit, nivelin bachelor, master ose doktoraturë. Termi "arsim i lartë" përdoret në të gjithë këtë raport dhe jo arsim terciar për shkak të përdorimit të tij më të gjerë në literaturën akademike dhe politike.

Zhvillimi i sistemeve kombëtare të arsimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor që nga shpërbërja e Jugosllavisë është ndikuar nga lufta dhe konfliktet etnike, procesi i ndërtimit të kombit, demokratizimi, ndryshimet e rëndësishme të sistemit ekonomik dhe politik dhe integrimet evropiane. Këto zhvillime janë shoqëruar nga reduktimi i madh i financimit të qeverisë dhe shpërbërja e pjesshme e sistemeve arsimore pas luftës, integrimi në procesin e Bolonjës dhe në fushën e arsimit të lartë evropian, dhe nga reformat strukturore në sektorin publik që ndikuan në arsim.

## **2.3. Përkufizimi i "korrupsionit", "rreziqeve të korrupsionit", "faktorëve të rrezikut të korrupsionit" dhe "vlerësimit të rrezikut të korrupsionit"**

Për qëllimet e këtij dokumenti, termi "korrupsion" buron nga standardet ndërkombëtare të mëposhtme: Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Penale mbi Korrupsionin (ETS 173)<sup>10</sup>; Rekomandimi i Këshillit të Evropës (2000)10E 11 maj 2000 mbi Kodet e Sjelljes për Zyrtarët Publikë;<sup>11</sup> dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC).<sup>12</sup> Me fjalë të tjera, termi korrupsion shkon përtej ryshfetit dhe formave të tjera të marrjes ose dhënies së avantazheve të padrejta për zyrtarët në lidhje me punën ose pozicionin e tyre në institucionet e arsimit të lartë. Me qëllim të përvetësimit të qasjes së gjerë ndaj CRA, termi "korrupsion", sipas nevojës, përfshin shkeljen e integritetit, sjellje të tjera jo-etike dhe praktika të tjera që, nëse ushtrohen nga zyrtarët/punonjësit, zakonisht konsiderohen si sjellje korruptive (p.sh. konflikti i interesave, shmangia e përgjegjësisë, transferimi i punonjësve etj.).

**Korrupsioni në Sektorin e Arsimit të Lartë** merr forma të ndryshme, duke filluar nga ryshfeti në rekrutime dhe pranime, nepotizmi dhe patronazhi në postet me mandat, ndikimi i padrejtë politik dhe i korporatës në kërkime, plagjiaturë dhe sjellje të tjera të pahijshme publikimi në revistat akademike. Korrupsioni në këtë sektor ekziston në nivele sistemike (mashttrim, ndikim i padrejtë, parregullsi në akreditime, etj.) dhe individuale (sjellje akademike të pahijshme, plagjiaturë, kopjim, konflikt interesi, etj.).<sup>13</sup>

<sup>10</sup> <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=173>

<sup>11</sup> <https://rm.coe.int/16806cc1ec>

<sup>12</sup> <https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/>

<sup>13</sup> <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/topic-guides/Topic-Guide-Corruption-in-Education.pdf>



**Rreziku i korrupsionit** paraqet mundësinë e korrupsionit, praktikave të papranueshme nga ana etike dhe profesionale ose parregullsi të tjera që kërcënojnë integritetin e institucionit/sectorit. Identifikimi i rrezikut nënkupton njohjen e të gjitha llojeve të mundshme të korrupsionit - manifestime të korrupsionit, veprime etike dhe profesionale të papranueshme të aktorëve të caktuar në proceset e punës - që mund të ndodhin.<sup>14</sup>

**Faktorët e rrezikut të korrupsionit** janë rrethana (në nivele të ndryshme) që mund të nxisin, shkaktojnë ose lejojnë sjellje korruptive ose jo-etike. Çdo rrezik korrupsioni shkaktohet nga një ose më shumë faktorë. Tipologjia më e përshtatshme e faktorëve të rrezikut është si në vijim:

- **Faktorët e rrezikut të jashtëm dhe sistemik** - faktorët jashtë kontrollit të institucionit ose sektorit, për të cilët ata duhet ose mund të jenë në dijeni (legjislacioni i paqartë ose jokonsistent që rregullon një sektor të caktuar, fushën e punës së institucionit; kompetenca të paqarta të autoriteteve; institucione mbikëqyrëse ose autoritete mbikëqyrëse joefikase ose jokompetente).
- **Faktorët e rrezikut të brendshëm (organizativ, institucional)** - faktorët brenda kontrollit të institucionit ose sektorit, siç janë rregullat dhe politikat për qeverisjen e mirë, menaxhimin, vendimmarrjen, udhëzuesi operacional dhe rregullore të tjera të brendshme që i mundësojnë organizatës të përmbushë objektivat, misionin dhe detyrat e saj.
- **Faktorët individualë të rrezikut** - faktorët që mund të nxisin një zyrtar/punonjës individual për të kryer sjellje korruptive ose jo-etike (mungesë njohurish-padituri, mungesë aftësish praktike-përvojë, tensione në mjedisin e punës, mosdeklarim të konfliktit të interesit).
- **Faktorët e rrezikut të procesit të punës** - faktorët që lindin nga procedurat dhe proceset e punës në një institucion (zyrtarët kanë nivel të lartë të diskrecionit dhe autonomisë personale në vendimmarrje, vendimmarrje jo transparente ose të paregjistruar, organizim të dobët të proceseve të punës, procese jo të lidhura të punës dhe mangësi procedurale, duke rezultuar në mungesë përgjegjësie apo mosnjohje të kompetencave dhe mungesë të kontrolleve vertikale apo horizontale në proceset e punës).<sup>15</sup>

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve konkrete të korrupsionit dhe faktorëve të rrezikut sipas tipologjisë së përmendur është i nevojshëm për përcaktimin e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve.

**Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit** përfaqëson mjetin parandalues për identifikimin e rreziqeve të korrupsionit dhe faktorëve të rrezikut në institucione/sectorë me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të masave për zbutjen ose eliminimin e këtyre faktorëve dhe rreziqeve. Si i tillë, vlerësimi i rrezikut të korrupsionit është një mjet menaxhimi për përmirësimin e qeverisjes së një institucioni ose sektori të caktuar të sektorit publik. Nëse rreziqet e korrupsionit nuk menaxhohen siç duhet, ato herët a vonë do ta ekspozojnë institucionin ose sektorin ndaj mundësisë më të madhe që zyrtarët publikë dhe stafi të përfshihen në sjellje

---

<sup>14</sup> Shih Ljiljana Selinšek, Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe – Comparative Research and Methodology, Sarajevo: Regional Cooperation Council, 2015, i disponueshëm në: [https://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA\\_in\\_public\\_ins\\_in\\_SEE-WEB\\_final.pdf](https://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA_in_public_ins_in_SEE-WEB_final.pdf)

<sup>15</sup> *Ibid*

korruptive ose joetike. Ekzistojnë tre qasje të ndryshme, por që lidhen me CRA: Plani i integritetit, CRA sektoriale dhe CRA e synuar (e posaçme).

- **Plani i Integritetit** përfaqëson mjetin e vetëvlerësimit institucional i cili trajton faktorët konkretë të rrezikut organizativ, faktorët që krijohen nga proceset specifike të punës dhe faktorët individualë të rrezikut në institucionin publik konkret. Është modeli më i përfaqësuar në rajonin e Evropës Juglindore.
- **Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në sektor** nga ana tjetër fokusohet më shumë në karakteristikat sistemike, sfidat dhe pozicionin e një sektori të caktuar. Më saktësisht, CRA sektoriale fokusohet më shumë në faktorët e rrezikut sistemik, si dhe në rreziqet dhe faktorë të tjerë rreziku që janë në thelb të ngjashëm në të gjitha institucionet brenda sektorit (për shembull, faktorët e rrezikut që i referohen sistemit të prokurimit publik, buxhetimit ose për menaxhimin e burimeve njerëzore).
- **CRA e posaçme** synon një projekt ose politikë të caktuar.

Praktika tregoi se nuk ka asnjë arsye pse CRA sektoriale nuk duhet të ndërthuret ose plotësohet me planin e integritetit. Domethënë, vlerësimi i përgjithshëm sektorial i rrezikut të korrupsionit mund të bëhet për sektorin e Arsimit të Lartë, ndërkohë që çdo institucion brenda këtij sektori duhet të përgatisë planin e integritetit/planin e vet të menaxhimit të rrezikut të korrupsionit. Në këtë rast, CRA sektoriale duhet të identifikojë rreziqet e korrupsionit në një nivel makro, ndërsa planet e integritetit/planet institucionale të menaxhimit të rrezikut të korrupsionit duhet t'i trajtojnë ato më tej në një nivel mikro ku mund të merren masa shumë konkrete dhe të përshtatura për të shmangur ose zbutur rreziqe të caktuara.

#### 2.4. Standardet dhe praktikat ndërkombëtare

**Nuk ka asnjë qasje universale për CRA. Procesi varet nga nevojat ose arsyet që nxisin një institucion, sektor ose vend të kryejë vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit. Procedura e vlerësimit, si dhe sukcesi i procesit, ndikohet kryesisht nga mjedisi lokal dhe kultura e integritetit.** CRA është një mjet i krijuar fillimisht në sektorin privat dhe i zhvilluar si pjesë e vlerësimit të rrezikut të biznesit të operatorëve ekonomikë.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) është dokumenti i parë ndërkombëtar ku shtetet palë janë të detyruara të prezantojnë sisteme efektive dhe efikase të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm.<sup>16</sup> Udhëzuesi Teknik i UNCAC (Udhëzuesi) fokusohet në kontrollin e brendshëm, domethënë, auditimin e brendshëm, pa udhëzime të mëtejshme se cilat janë sistemet efektive të menaxhimit të rrezikut, formën, përmbajtjen, mënyrën si kryhet procesi, etj.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), neni 9, paragrafi 2, pika d, ndër të shpjegon që:

Çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij ligjor, do të marrë masat e duhura për të nxitur transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e financave publike. Këto masa, ndër të tjera, do të përfshijnë: d) Sistemet efektive dhe efikase të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm.

<sup>17</sup> Shihni 2009 United Nations Office on Drugs and Crime Vienna, Technical Guide to the United Nations Kundër Korrupsionit, fq. 40-42: <https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CAC/technical-guide.html>.

Një nga standardet ndërkombëtare më gjithëpërfshirëse në menaxhimin e rrezikut është standardi ISO 31000. Shumica e metodologjive të hartuara për menaxhimin e rreziqeve të korrupsionit në nivel institucional, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, mbështeten drejtpërdrejt në standardet ISO 3100:2018. Këto standarde ofrojnë kushtet kryesore për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.<sup>18</sup>

Në kontekstin e menaxhimit të rrezikut të korrupsionit, sistemi i menaxhimit kundër rryshfetit ISO 37001 është i rëndësishëm.<sup>19</sup> ISO nuk ka publikuar ende udhëzues publikë për këtë standard.

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) ka zhvilluar disa dokumente që përmbajnë rekomandime dhe shembuj të praktikave më të mira të cilat janë të dobishme në hartimin dhe zbatimin e CRA në nivel kombëtar dhe institucional si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Më saktësisht në vitin 2005, OECD publikoi “Integritetin e Sektorit Publik – Kuadri për Vlerësimin”<sup>20</sup> me qëllimin kryesor për të paraqitur përvojat e vendeve të ndryshme me procedurat e vlerësimit të integritetit dhe masat parandaluese kundër korrupsionit. Gjithashtu, Rekomandimi i OECD 2017 për Integritetin Publik (Rekomandimi) është i rëndësishëm<sup>21</sup>. Qëllimi i Rekomandimit është që vendet anëtare dhe jo-anëtare të OECD të ndërtojnë një sistem koherent dhe gjithëpërfshirës të integritetit publik.

Transparency International ka zhvilluar 10 parime praktike të mira për vlerësimin efektiv të rrezikut të korrupsionit, të cilat janë të natyrës së përgjithshme dhe plotësisht të zbatueshme edhe për rajonin e Evropës Juglindore.<sup>22</sup> Sipas këtyre parimeve, vlerësimi efektiv i rrezikut (veçanërisht ai institucional) duhet: 1. të ketë mbështetjen dhe angazhimin e plotë nga eprori ose stafi i lartë drejtues, 2. të përfshijë njerëzit e duhur për të siguruar një përmbledhje të mjaftueshme me informacione dhe të plotë të institucionit dhe rreziqeve të tij, 3. të jetë gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh të gjitha veprimtaritë e institucionit të cilat mund të krijojnë rrezik të konsiderueshëm të korrupsionit, 4. të shmangë paragjykimet në lidhje me efektivitetin e kontrolleve ose integritetin e punonjësve dhe palëve të treta, dhe për këtë arsye të fokusohet në rrezikun e brendshëm, 5. të identifikojë dhe të përshkruajë rreziqet e korrupsionit në detajet e duhura, 6. të vlerësojë rreziqet e korrupsionit me referencë për një vlerësim real të gjasave dhe ndikimit, 7. të prioritzojë rreziqet e korrupsionit në masën që kjo është praktike dhe kuptimplote, 8. të dokumentohet në mënyrë të tillë që të tregojë se është kryer një proces efektiv i vlerësimit të rrezikut, 9. të jetë i rregullt, të kryhet në intervale të përshtatshme dhe në rastin e kundërt në rast të ndryshimeve të rëndësishme që prekin sektorin publik, 10. të komunikohet në mënyrë efektive dhe të hartohet në një mënyrë që lehtëson komunikimin efektiv dhe hartimin e politikave, programeve dhe kontrolleve të përshtatshme.

**Dokumentet e mëposhtme kanë një rëndësi të veçantë për CRA sektoriale në Sektorin e Arsimit të Lartë: Kuadri konceptual – Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në nivel sektorial, i**

<sup>18</sup> ISO 31000:2018 Menaxhimi i rrezikut — Udhëzuesit: <https://www.iso.org/standard/65694.html>

<sup>19</sup> Shihni në <https://www.iso.org/publication/PUB100396.html>

<sup>20</sup> [https://read.oecd-ilibrary.org/governance/public-sector-integrity\\_9789264010604-en#page1](https://read.oecd-ilibrary.org/governance/public-sector-integrity_9789264010604-en#page1)

<sup>21</sup> <https://www.oecd.org/gov/ethics/OECD-Recommendation-Public-Integrity.pdf>

<sup>22</sup> [https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/4-537-0225?transitionType=Default&contextData=\(sc.Default\)#co\\_anchor\\_a915639](https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/4-537-0225?transitionType=Default&contextData=(sc.Default)#co_anchor_a915639)

publikuar nga UNDP në 2018,<sup>23</sup> dhe Monitorimi i Korrupsionit dhe veprimtarive kundër korrupsionit në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, botuar nga Transparency International në 2017.<sup>24</sup> Megjithatë, nuk ka asnjë standard ndërkombëtar që përfshin të gjitha ose shumicën e rreziqeve të korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë. Asnjë nga standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit nuk i referohet në mënyrë specifike sektorit të arsimit të lartë, por ato përmbajnë “vetëm” dispozita të përgjithshme kundër korrupsionit (parandalimi, kriminalizimi, etj.).

**Në shumicën e vendeve që prezantojnë plane integriteti, organet kompetente kundër korrupsionit zhvilluan modele të planeve të integritetit të përshtatura për institucionet në Sektorin e Arsimit të Lartë.** Këto modele përmbajnë fusha/procese të identifikuar të rrezikut me rreziqet dhe faktorët e korrupsionit si dhe propozime të masave për reduktimin e rreziqeve/faktorëve të identifikuar të korrupsionit. Megjithatë, duke pasur parasysh se Plani i Integritetit përfaqëson një mjet të vetëvlerësimit institucional që nuk trajton faktorët sistematik të rrezikut, zbatimi i tij ka ndikim të kufizuar.

Ka disa studime në rang ndërkombëtar ose kombëtar për korrupsionin në sektorin e arsimit të lartë të juridiksioneve të ndryshme. Në të shumtën e rasteve, këto studime nuk kanë në fokus vetëm në CRA për këtë sektor. Megjithatë, ato përfshijnë disa konstatime për problemet e identifikuar dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për reforma të mundshme normative, institucionale dhe praktike në Sektorin e Arsimit të Lartë.<sup>25</sup> Gjithashtu, këto dokumente janë përdorur si burim shtesë për verifikimin e konstatimeve tona të hulumtimit dhe identifikimin e rreziqeve të korrupsionit dhe faktorëve të rrezikut.

Nga njëra anë mungesa e standardeve universale ndërkombëtare në trajtimin e rreziqeve të korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe nga ana tjetër ngjashmëritë, kuadri dhe sfidat e përbashkëta në këtë sektor (veçanërisht në rajonin e synuar nga kjo ndërhyrje) justifikojnë zbatimin e udhëzuesit me listat e kontrollit, si një mjet i rëndësishëm që mund të zbatohet në nivel rajonal dhe që do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së këtij sektori.

## **2.5. Konteksti i Sektorit të Arsimit të Lartë në perspektivat rajonale - praktikat e mira dhe fushat për përmirësim**

---

<sup>23</sup> P. 30-38, i disponueshëm në, <https://discuss.tp4.ir/uploads/short-url/4XCIJ0Hcxn87AA16WiFMAHLUmoq.pdf>

<sup>24</sup> P 34-48, i disponueshëm në [2017\\_MonitoringCorruptionSDGs\\_EN.pdf](https://transparencycdn.org/2017_MonitoringCorruptionSDGs_EN.pdf) (transparencycdn.org)

<sup>25</sup> Për shembull, Ararat L. Osipian, Grey Areas in the Higher Education Sector: Legality versus Corruptibility, 2012 BYU Educ. & L.J. 141 (2012), i disponueshëm në: <https://digitalcommons.law.byu.edu/cgi/viewcontent.cgi?referer=&httpsredir=1&article=1310&context=elj>, OECD Anti-Corruption Network for Eastern Europe and Central Asia, Integrity of Education Systems - A Methodology for Sector Assessment, 2018, <https://www.oecd.org/corruption/acn/OECD-ACN-Integrity-of-Education-Systems-ENG.pdf>, [https://www.thebalkanforum.org/file/repository/Education\\_Briefing\\_ENG\\_FINAL.pdf](https://www.thebalkanforum.org/file/repository/Education_Briefing_ENG_FINAL.pdf), [https://unesdoc.unesco.org/in/documentViewer.xhtml?v=2.1.196&id=p::usmarcdef\\_0000265784&file=/in/res\\_t/annotationSVC/DownloadWatermarkedAttachment/attach\\_import\\_0a156da8-248d-47ed-87b9-43bc3e697cce%3F\\_%3D265784eng.pdf&locale=en&multi=true&ark=/ark:/48223/pf0000265784/PDF/265784eng.pdf#MEP\\_Georgie.BAT.WEB.indd%3A.39467%3A898](https://unesdoc.unesco.org/in/documentViewer.xhtml?v=2.1.196&id=p::usmarcdef_0000265784&file=/in/res_t/annotationSVC/DownloadWatermarkedAttachment/attach_import_0a156da8-248d-47ed-87b9-43bc3e697cce%3F_%3D265784eng.pdf&locale=en&multi=true&ark=/ark:/48223/pf0000265784/PDF/265784eng.pdf#MEP_Georgie.BAT.WEB.indd%3A.39467%3A898), [https://eua.eu/downloads/content/western\\_balkan\\_report\\_final\\_-\\_2018\\_07\\_02.pdf](https://eua.eu/downloads/content/western_balkan_report_final_-_2018_07_02.pdf), [https://epoka.edu.al/mat/staff\\_guide.pdf](https://epoka.edu.al/mat/staff_guide.pdf)

Të gjitha juridiksionet e synuara identifikuan arsimin e lartë si një nga fushat kryesore për interesin publik. Meqenëse të gjitha juridiksionet e synuara deklaruan integritet në BE si një nga prioritetet, legjislacioni i tyre për arsimin e lartë ishte në përputhje me politikat e vendeve të BE në këtë fushë. Ky proces kërkonte reforma thelbësore në Sektorin e Arsimit të Lartë që zgjatën për gati dy dekada dhe janë ende në vazhdim, me rezultate relativisht të ndryshme. (*Procesi i Bolonjës*).

Një rol qendror në hartimin e ligjeve dhe politikave publike për sektorin e arsimit të lartë kanë ministritë e arsimit. Gjithashtu, në disa juridiksione krijohen këshillat kombëtarë të arsimit të lartë si organe përgjegjëse për avancimin dhe përparimin e arsimit të lartë përmes analizimit të situatës dhe arritjeve në arsimin e lartë dhe propozimeve të ekspertëve në institucionet e tjera kompetente. Sektori i Arsimit të Lartë në të gjitha juridiksionet përmban një rreth të gjerë institucionesh (universitete, fakultete, institute shkencore, organe për akreditimin dhe sigurimin e cilësisë, etj.). Gjithashtu, në të gjitha juridiksionet, institucionet e arsimit të lartë kanë një nivel të lartë të shpallur të autonomisë dhe kompetencës për të vetërregulluar shumë çështje. Ky fakt paraqet një sfidë të rëndësishme lidhur me përshtatjen uniform të të gjitha rregullave përkatëse. Duke marrë parasysh gjithçka që u përmend, të gjitha juridiksionet krijuan një grup kompleks kuadri ligjor dhe institucional për Sektorin e Arsimit të Lartë.

**Pothuajse të gjitha juridiksionet pranojnë që Sektori i Arsimit të Lartë është i prirur ndaj korrupsionit dhe e përfshinë atë në dokumentet strategjike/politikat publike kundër korrupsionit.** Gjithashtu, disa nga juridiksionet zhvilluan strategji sektoriale për arsimin e lartë. Megjithatë, duket se masat kundër korrupsionit dhe masat nga strategjitë sektoriale nuk janë të harmonizuara sa duhet. Gjithashtu, problemi i identifikuar në këtë sektor është se institucionet arsimore ende shfaqin ndërjegjësim relativisht të ulët për trajtimin e korrupsionit.<sup>26</sup> Kjo shkakton një ndarje të paqartë të përgjegjësisë dhe shpërndarje të pronësisë ndaj politikave kundër korrupsionit ndërmjet institucioneve arsimore dhe agjencive kundër korrupsionit, ndonëse ekziston një nevojë e madhe për të punuar së bashku në këtë temë.

Një nga konstatimet e hulumtimit është se shumica e juridiksioneve ndajnë probleme të ngjashme me korrupsionin në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe se mund të prezantohen ndërhyrje të përbashkëta dhe të ngjashme.

**Ndërsa disa nga juridiksionet synojnë Sektorin e Arsimit të Lartë vetëm përmes CRA sektoriale (Maqedonia e Veriut, për shembull), fokusi në disa juridiksione është në mjetet e vetëvlerësimit të CRA (Serbi, Mali i Zi).** Gjithashtu, disa juridiksione (për shembull, Bosnja dhe Hercegovina) kombinojnë qasje të ndryshme, ndërkohë që, sipas të dhënave të disponueshme, vetëm Shqipëria nuk e merr parasysh Sektorin e Arsimit të Lartë në dokumentet e saj strategjike kundër korrupsionit dhe nuk ka mjet CRA.

**Sipas të dhënave të disponueshme, shumica e hulumtimeve dhe raporteve për korrupsionin në Sektorin e Arsimit të Lartë vijnë nga organizata ndërkombëtare, projekte dhe organizata të shoqërisë civile.** Gjithashtu, hulumtimet dhe raportet kryesisht fokusohen ende në

---


<sup>26</sup> Shpjegime të mëtejshme të sfidave për fokusimin e korrupsionit në HES mund të shihen, për shembull, në National Strategy for Prevention of Corruption and Conflict of Interest (2021-2025), Republika e Maqedonisë së Veriut, i disponueshëm në [https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/09/NACS-2021\\_25-and-Action-Plan-EN-final.pdf](https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/09/NACS-2021_25-and-Action-Plan-EN-final.pdf)

identifikimin e problemeve, rreziqeve dhe perceptimit të korrupsionit, ndërkohë që ka shumë pak raporte që japin përgjigje për efektet dhe rezultatet e përpjekjeve kundër korrupsionit në këtë drejtim.

Niveli i korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë midis juridiksioneve të anketuara vlerësohet si relativisht i moderuar, **me 5.6 në shkallën nga 1 në 10** (1 – nuk ka korrupsion, 10 – korrupsioni shumë i lartë). Por një masë tjetër statistikore (modaliteti – 7, mesatarja 6.5) tregon se ka më shumë të anketuar që zgjedhin rezultate më të larta në shkallë (mbi 6) sesa ata që mendojnë se niveli i korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë mund të përshkruhet si më poshtë 5.


**Korrupsioni i madh është një lloj korrupsioni që sipas përgjigjeve të mbledhura prek më së shumti sektorin e arsimit të lartë ndër llojet e tjera.** Në shkallën 1 deri në 5, rezultati mesatar për ndikimin e korrupsionit të madh në këtë sektor është 3.5. Kapja e shtetit është në vendin e dytë, ndërsa përfaqësuesit e juridiksioneve përkatëse kombëtare besojnë se korrupsioni administrativ ose i vogël rrezikon më së paku Sektorin e Arsimit të Lartë. Megjithatë, rezultatet për të tre llojet e korrupsionit janë mbi mesataren (2.5) dhe mund të arrihet në përfundimin se korrupsioni, në përgjithësi prek rëndë Sektorin e Arsimit të Lartë.

*Çfarë rrezikon funksionimin e duhur të Sektorit të Arsimit të Lartë dhe si rrjedhojë ndikon në cilësinë e shërbimeve të Sektorit të Arsimit të Lartë në juridiksionin tuaj?*



Sipas rezultateve të sondazhit, ekziston një nevojë e madhe për të përmirësuar transparencën në punën e Sektorit të Arsimit të Lartë, veçanërisht në fusha si shpërblimi dhe përfitimet shtesë, të ardhurat e stafit; angazhimi i stafit pedagogjik në fakultetet e tjera dhe disponueshmëria e statistikave për sanksionet ndaj stafit për korrupsion, të cilët konsiderohen si më pak transparentët.

*Si do ta vlerësonit transparencën, d.m.th., nivelin e aksesit në informacionin publik lidhur me sa vijon? (1 – Transparencë e ulët, 5 – Transparencë e lartë)*



Të anketuarve iu dha lista me 17 llojet e korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë dhe iu kërkua t'i rendisnin për të identifikuar ato që perceptohen si llojet më të zakonshme dhe më aktuale në këtë sektor. Kjo pyetje synonte të eksploronte më tej lidhjen midis fushave/proceseve të identifikuara të prirura ndaj korrupsionit me rreziqet e korrupsionit që duhet të synohen në Sektorin e Arsimit të Lartë. Tre format më të zakonshme të korrupsionit, të renditura nga të anketuarit, janë **Nepotizmi, Plagjiatura dhe Kronizmi**. Nga ana tjetër, të anketuarit renditën **Rrjedhjen e informacionit konfidencial/të ndjeshëm, pasurimin e paligjshëm, donacionet e bamirësisë dhe sponsorizimet** si tre llojet më pak të pranishme të korrupsionit.

Për të identifikuar shkaqet e llojeve më të pranishme të korrupsionit në fushat/proceset brenda Sektorit të Arsimit të Lartë, pyetësi përfshinte edhe këtë pyetje. Qëllimi i kësaj pyetje ishte të mundësonte identifikimin më të lehtë të masave të mundshme në listat e kontrollit. Si faktorët më të zakonshëm të rrezikut të korrupsionit, të anketuarit përzgjedhën **Mungesën e integritetit profesional, Mungesën e trajnimit të përshtatur mbi etikën, konfliktin e interesit dhe rregullat e përputhshmërisë dhe Mungesën e promovimit aktiv të rregullave të etikës, konfliktit të interesit dhe përputhshmërisë**.

Përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave përkatëse nga juridiksionet kombëtare janë mesatarisht të kënaqur me përpjekjet në luftën kundër korrupsionit në Sektorin e Arsimit të Lartë në juridiksionet e tyre. **Rezultati mesatar në shkallën 1 deri në 5 është 3.**


**Në rajonin e Evropës Juglindore (EJL) ka një mungesë të theksuar informacioni rreth korrupsionit dhe implikimeve të tij tek femrat, gjë që duhet të trajtohet nga aspekti i perceptimit dhe sondazhet të bazuara në përvojë.** Ka shumë pyetje dhe hipoteza mbi natyrën dhe pasojat e lidhjes ndërmjet gjinisë dhe korrupsionit (për shembull, sa shpesh përballen gratë me korrupsion, sa të përhapura janë llojet e korrupsionit në baza gjinore, nëse gratë janë më shpesh subjekt i korrupsionit kur kërkojnë shërbime publike, në çfarë mase njihen dhe adresohen në mënyrë të përshtatshme në diskutimet publike, dokumentet e politikave dhe rregulloret ligjore pozitive në Evropën Juglindore, nëse femrat janë ato që

raportojnë më shumë korrupsionin dhe ngjarje të ngjashme<sup>27</sup>). Për tu fokusuar tek marrëdhënia komplekse, disa nga pyetjet më të rëndësishme janë nëse korrupsioni prek më shumë femrat sesa meshkujt dhe a ka rreziqe të korrupsionit që janë specifike gjinore, d.m.th., rreziqe të korrupsionit që bazohen në marrëdhënie të ndryshme të ndërtuara mbi dallimet ndërmjet gjinive.

Në Sektorin e Arsimit të Lartë, **fenomeni i favoreve seksuale** është identifikuar si një nga format kryesore të korrupsionit, bazuar në raportin e pushtetit, kryesisht mes studenteve femra dhe personelit meshkuj të universitetit, ku favorët seksuale janë “paratë e rryshfetit”.<sup>28</sup>. Prandaj, përveç faktit që ky është një problem që lidhet me korrupsionin, favorët seksuale janë manifestim i diskriminimit gjinor dhe marrëdhënive të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave në universitet.

Sondazhi i kryer midis përfaqësuesve të juridiksioneve të synuara u përdor për të studiuar gjininë dhe korrupsionin në HES, dhe, në përputhje me rrethanat, për të prezantuar disa nga ndërhyrjet lidhur me gjininë në udhëzuesin dhe listën e kontrollit të CRA për të synuar korrupsionin në HES.

Shumica e të anketuarve besojnë se femrat dhe meshkujt janë njëloj të cenueshëm ndaj korrupsionit në arsimin e lartë (58%). Me fjalë të tjera, përfaqësuesit e aktorëve në juridiksionet e synuara vlerësojnë se nuk ka dallim ndërmjet femrave dhe meshkujve në lidhje me faktorët, rreziqet ose pasojat e korrupsionit.



<sup>27</sup> Për më shumë informacion në lidhje me këtë temë, shih **The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption**, UNODC, Vienna, 2020, i disponueshëm në


[https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE\\_TIME\\_IS\\_NOW\\_2020\\_12\\_08.pdf](https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf)

<sup>28</sup> Për më shumë informacion në lidhje me këtë temë, shih studimin e mëposhtëm: **Corruption in universities: Paths to integrity in the higher education subsector**, U4 Anti-Corruption Resource Center, 2019, i disponueshëm në: <https://www.u4.no/publications/corruption-in-universities-paths-to-integrity-in-the-higher-education-subsector.pdf>




Pavarësisht konstatimeve se shumica e të anketuarve besojnë se meshkujt dhe femrat janë një lloj të cënueshëm ndaj korrupsionit në universitet, **shumica e të anketuarve (58%) i njohin favorët seksuale në arsimin e lartë si lloj i korrupsionit**. Një e treta e të anketuarve (33%) nuk janë të sigurt, d.m.th., nuk e dinë nëse favorët seksuale janë një lloj korrupsioni. Ky konstatim shumë i rëndësishëm tregon se ndonëse shumica e aktorëve të rëndësishëm në nivel kombëtar janë të vetëdijshëm se favorët seksuale është rrezik i korrupsionit në HES, ekziston ende një nevojë e madhe për studime të mëtejshme dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë temë të rëndësishme.

*A mendoni se favorët seksuale (favorët seksuale në këmbim të shërbimeve apo trajtimit të veçantë) në arsimin e lartë janë një lloj korrupsioni?*




Gjysma e të anketuarve nuk kanë njohuri nëse favorët seksuale janë më të zakonshme ose mund të ndodhin në institucionet e arsimit të lartë publik apo privat. Ky konstatim nënkupton se nuk ka të dhëna ose sondazhe të mjaftueshme që merren me këtë çështje. Njerëzit, edhe njerëzit e informuar dhe të përfshirë, si përfaqësues të organizatave përkatëse, nuk kanë shumë njohuri për këtë problem. Në gjysmën tjetër të anketuarve, më shumë besojnë se favorët seksuale ndodhin më shumë në universitetet publike sesa në ato private. Arsyet për këtë qëndrim duhet të jenë çështje e hulumtimeve dhe analizave të mëtejshme.

*A mendoni se favorët seksuale janë më të zakonshme ose mund të ndodhin në institucionet e arsimit të lartë publik ose privat?*



Ndër pesë aktivitetet e mundshme që synojnë të reduktojnë rreziqet e korrupsionit në arsimin e lartë që prek femrat, shumica e të anketuarve (67%) zgjedhin *rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe prezantimin e trajnimeve kundër korrupsionit dhe integritetit si masën më të rëndësishme*. Në vend të dytë, 50% e të anketuarve *theksojnë procedurat më efikase dhe efektive të sinjalizimit* si të nevojshme për tu fokusuar tek korrupsioni në HES në lidhje me gjininë në HSE. Këto konstatime janë të rëndësishme për të gjithë aktorët për të planifikuar punën e mëtejshme në studimin dhe fokusimin tek gjinia dhe korrupsioni në HES.



**Bazuar në përvojat e zhvillimit të politikave kombëtare kundër korrupsionit dhe mjeteve për të luftuar korrupsionin në Sektorin e Arsimit të Lartë, disa shembuj të praktikave të mira**

**mund të identifikohen, promovohen dhe përdoren më tej për përmirësim në nivel të plotë rajonal.**

Krahas trajtimit të nivelit të lartë strategjik, korrupsioni në Arsimin e Lartë duhet të synohet në nivel institucional/sektorial përmes mjeteve të ndryshme të CRA. Autonomia e institucioneve të HES kërkon që çdo institucion të mbajë përgjegjësi për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit. Planet e integritetit në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi mund të shihen si shembuj të praktikës së mirë të CRA me potencialin për tu përmirësuar më tej. Ky përmirësim mund të bazohet në një zbatim të përbashkët të planeve të integritetit për institucionet e arsimit të lartë dhe CRA sektoriale për të gjithë sektorin e arsimit të lartë. Në këtë rast, CRA sektoriale duhet të identifikojë rreziqet e korrupsionit në një nivel makro, ndërsa planet e integritetit duhet t'i trajtojnë ato më tej në një nivel mikro ku mund të merren masa shumë konkrete për të shmangur ose zbutur rreziqe të caktuara.

Një bashkëpunim më i ngushtë dhe më intensiv kërkohet ndërmjet organeve kundër korrupsionit dhe institucioneve të arsimit të lartë gjatë zhvillimit dhe zbatimit të masave dhe mjeteve kundër korrupsionit. Deri tani duket se ky bashkëpunim është shumë modest. Institucionet e arsimit të lartë janë njohur me organizimet e brendshme, sfidat dhe funksionimin e sektorit, ndërsa organet antikorrupsion kanë përvojë dhe njohuri të gjerë mbi politikatat kundër korrupsionit. Shkëmbimi i përvojave ndërmjet juridiksioneve është një hapësirë me potencial të lartë për përmirësim. Listat e kontrollit të CRA janë një nga mënyrat për të punuar më tej në këtë fushë.

Bazuar në fazën e vlerësimit të detyrave, e cila përfshinte analizën e politikave kombëtare kundër korrupsionit në juridiksionin e synuar, mjetet dhe mekanizmat e disponueshëm kundër korrupsionit, diskutimin dhe anketimin me përfituesit, si dhe hulumtimet dhe analizat në lidhje me korrupsionin në HES, u identifikuan katër fushat e mëposhtme për t'u bërë funksionale më tej përmes udhëzuesve dhe listave të kontrollit të CRA: **1) Provimet e studentëve, 2) Puna studentore dhe shkencore, 3) Menaxhimi i stafit të mësimdhënies dhe 4) Akreditimi/lëshimi i lejeve për institucionet private të arsimit të lartë.** Meqenëse fushat e përzgjedhura janë komplekse dhe shumica e tyre përfshijnë më shumë se një proces me rreziqe relativisht të ndryshme korrupsioni dhe masa për të zbutur këto rreziqe, fushat janë ndarë në procese siç përshkruhen në tabelën më poshtë. Më tej, u përshkruan rreziqet më të zakonshme të korrupsionit në procese dhe u përcaktuan pyetjet për të kontrolluar masat për zbutjen e rreziqeve për përdorim të mëtejshëm në përpjekjet e CRA, siç përshkruhet në seksionin 2.6 të Udhëzuesit.

*Fushat dhe proceset e identifikuar brenda Sektorit të Arsimit të Lartë për t'u përfshirë në listën e kontrollit të CRA*

<b>Fusha</b>	<b>Procesi</b>
Provimet e studentëve	Planifikimi i provimeve
	Dhënia e provimeve
Punimet shkencore dhe studentët	Punimet e studentëve (ese, seminare dhe punime të tjera me shkrim të studentëve gjatë studimit si pjesë e provimeve)
	Punimi përfundimtar i studentëve, teza e magjistraturës dhe doktoraturës (punimet që kërkohen për marrjen e një niveli të caktuar diplome)

	Punimet Shkencore (punimet e profesorëve/shkencëtarëve të botuara në revista dhe që kërkohen për promovim dhe zhvillim të mëtejshëm në karrierë).
Menaxhimi i Stafit	Punësimi i stafit të mësimdhënies
	Emërimi në poste drejtuese në institucionet e arsimit të lartë
	Puna shtesë e stafit të mësimdhënies
Akreditimi/lëshimi i lejeve për institucionet private të arsimit të lartë	Akreditimi fillestar i institucioneve private të arsimit të lartë
	Proceset e riakreditimit dhe të sigurimit të jashtëm të cilësisë

## 2.6. Si të zbatoni Udhëzuesin me listat e kontrollit në nivelin e juridiksioneve kombëtare?

Listat e kontrollit të CRA për Sektorin e Arsimit të Lartë përfaqësojnë një përmbledhje të rreziqeve më të përhapura të korrupsionit brenda fushave të përzgjedhura të përbashkëta të prirura ndaj korrupsionit dhe proceseve më të cenueshme brenda këtyre fushave në juridiksionet e synuara. Gjithashtu, listat e kontrollit ofrojnë një sërë pyetjesh kontrolli që kanë lidhje me ekzistencën/mos-ekzistencën e masave për zbutjen e rreziqeve të përshkruara në nivel sistematik dhe institucional. Përgjigjet e këtyre pyetjeve nga aktorët duhet t'i ndihmojnë ata në vlerësimin e nevojës për reagim në nivel sistematik ose institucional dhe të zbatojnë masat e mundshme në mënyrë që të zbusin rreziqet e identifikuar. Më saktësisht, nëse përgjigja për çdo pyetje të veçantë të kontrollit nga listat e kontrollit është *Jo*, aktorët kompetentë duhet të konsiderojnë zbatimin e aktiviteteve adekuate që dalin nga përgjigja e pyetjes. Përveç përgjigjes së pyetjeve përkatëse të kontrollit, për të vlerësuar në mënyrë të përshtatshme faktorët e rrezikut të jashtëm dhe sistematik, aktorët që marrin pjesë në përgatitjen dhe miratimin e politikave/rregulloreve publike përkatëse për Sektorin e Arsimit të Lartë duhet të shqyrtojnë gjithashtu nëse legjislacioni ekzistues përmban ndonjë nga faktorët e tjerë rregullator të rrezikut të korrupsionit, të përpunuar në Udhëzuesin e CPL me listat e kontrollit për këtë sektor. Nëse është e nevojshme, ata duhet të konsiderojnë fillimin/miratimin e ndryshimeve të duhura legjislative për të zbutur këta faktorë rreziku.

Listat e kontrollit mund të përdoren kryesisht nga ministritë kompetente, organet kundër korrupsionit, këshillat për arsimin e lartë, organet për akreditimin dhe sigurimin e cilësisë dhe universitetet, si një rikujtesë gjatë zhvillimit të reformave normative, institucionale, organizative ose praktike ose kryerjes së CRA në nivel sektorial apo institucional. Duhet të përsëritet se listat e kontrollit mund të ofrojnë vetëm një grup bazë pyetjesh me drejtimin që duhet të ndiqni. Pyetjet duhet tu përshtaten rrethanave specifike dhe duhet të kryhet shqyrtimi i kujdesshëm i të gjitha detajeve në legjislacion dhe praktikë në çdo juridiksion të vetëm që lidhet me secilën çështje.

### 3. Listat e kontrollit

#### 3.1. Fusha: Provimet e studentëve

Procesi	Rreziku nga korrupsioni	Pyetje
<p><b>Planifikimi i provimeve</b></p>	<p><b>Ryshfeti:</b> ofrimi i stafit administrativ me stimuj financiarë ose të tjerë në këmbim të shkeljes së rregullave dhe procedurave në aplikimet për provime (lejimi i provimeve në një kohë më të përshtatshme, lejimi i aplikimit të provimeve jashtë afateve, lejimi i ndryshimeve në aplikimet për provime).</p> <p><b>Favorizimi:</b> dhënia e preferencave të studentëve në procesin e aplikimit të provimit.</p> <p><b>Shitje informacioni/rrjedhje informacioni:</b> ofrimi i informacionit për studentët për orarin e provimeve përpara informacionit zyrtar në këmbim të përfitimeve të ndryshme.</p>	<p>1. A ekziston një sistem për aplikimet elektronike/online të provimeve?</p> <p>2. A ka kontrolle të mjaftueshme sigurie për të shmangur keqpërdorimet e mundshme sistemi për aplikimet elektronike të provimeve (sistem identifikimi me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik për çdo student)?</p> <p>3. A ka sistemi për aplikimet elektronike të provimeve një opsion për të gjurmuar çdo ndryshim në procesin e aplikimit për provim dhe që kërkon konfirmimin e përdoruesit për këto ndryshime (për të shmangur që dikush tjetër të hyjë në sistem dhe të ndryshojë të dhënat)?</p> <p>4. A publikohet orari për të gjitha provimet në fillim të çdo semestri?</p> <p>5. A publikohet në kohë çdo ndryshim në orarin e provimeve dhe a është i disponueshëm në kohë për të gjithë studentët (për shembull, një numër i caktuar ditësh para provimeve, me sistemin që njofton studentët për ndryshimin dhe të ngjashme)?</p> <p>6. A ka praktikë për të publikuar arsyet/arsyetimet e ndryshimeve në orarin e provimeve?</p>

		<p>7. A ekziston një sistem për të kontrolluar nëse studentët i kanë përmbushur të gjitha parakushtet e kërkuara për të bërë një provim para se të aplikojnë për provim (a janë përmbushur të gjitha detyrimet para provimit – seminare, testime, praktika e kërkuar dhe të ngjashme)?</p> <p>8. A publikohet lista e studentëve që aplikuan për të bërë një provim para provimit?</p> <p>9. A ka ndonjë procedurë për paraqitjen e ankesës për aplikimet/orarin e provimeve?</p> <p>10. A përmban procedura për paraqitjen e ankesave detyrimin e përgatitjes së raporteve për numrin, llojet dhe rezultatet e ankesave (statistikat e ankesave dhe rezultatet e tyre)?</p> <p>11. A janë publike këto raporte?</p>
<p><b>Dhënia e provimeve</b></p>	<p><b>Ryshfeti:</b> sigurimi i mësuesit me stimuj financiarë ose të tjerë në këmbim të trajtimit më të mirë/notës më të mirë në provim.</p> <p><b>Konflikti i Interesit:</b> studentët dhe mësuesit/pedagogët/pjesa tjetër e stafit të universitetit kanë marrëdhënie që shkaktojnë rrethana të ndryshme të konfliktit të interesit.</p>	<p>1. A parashikohet që marrja e provimit të jetë e hapur për publikun (apo a ndalohet kufizimi i aksesit të palës së tretë në provime)?</p> <p>2. A është e detyrueshme që të organizohen provimet vetëm nëse një palë e tretë është e pranishme (apo a është i ndaluar organizimi i provimeve nëse janë të pranishëm vetëm studenti dhe mësuesi)?</p> <p>3. A ka ndonjë procedurë për të paraqitur kundërshtim/ankim nëse provimi organizohet në mënyrë jo transparente (dhe për pasojë të ricaktohet/anulohet provimi)?</p>

	<p><b>Shpërdorimi i pozitës:</b> përdorimi i pozitës së pushtetit të mësuesve për të marrë përfitime të ndryshme nga studentët (një nga më të zakonshmet është kërkesa që studentët të blejnë librin e mësuesit nëse duan të marrin provimin).</p> <p><b>Shitje informacioni/rrjedhje informacioni:</b> ofrimi i kërkesave të provimeve për studentët (pyetje, tema) përpara provimit në këmbim të përfitimeve të ndryshme.</p> <p><b>Mashtrimi:</b> kopjimi gjatë provimit. Personi që ofron mundësinë për të kopjuar është pjesëmarrës në mashtrim.</p> <p><b>Favoret seksuale:</b> zhvatja e favoreve seksuale në këmbim të notës më të mirë në provim.</p>	<p>4. A bëhet procesverbali i dhënies së provimit gjatë provimit?</p> <p>5. A nënshkruhet procesverbali i dhënies së provimit nga studentit dhe mësuesi menjëherë pas provimit?</p> <p>6. A publikohen të dhënat e dhënies së provimeve me rezultatet e provimeve menjëherë pas provimit (në të njëjtën ditë)?</p> <p>7. A ekziston një sistem sigurie për zbulimin dhe parandalimin e mashtrimit të provimeve në internet (për shembull, identifikimi i personave që kanë akses në fjalëkalimet e përgjigjeve, mekanizmat për parandalimin e hakerimit dhe të ngjashme)?</p> <p>8. A ka mekanizma për monitorimin e provimeve dhe çfarë lloj mekanizmash ekzistojnë (për shembull, numri i nevojshëm/mjaftueshëm i personelit që monitoron provimet, kamerat, rikodimin, transmetimin e drejtpërdrejtë të provimeve dhe të ngjashme)?</p> <p>9. A ekziston një rregullore e brendshme publike për menaxhimin e Konfliktit të Interesit, që është e zbatueshme për situatat e konfliktit të interesit në procesin e dhënies së provimeve (konflikti i interesit mes studentëve dhe mësuesve/pedagogëve/ pjesëtarëve të tjerë të stafit të universitetit)?</p> <p>10. A ekziston një sistem për deklarimin e interesave private dhe për menaxhimin e mëtejshëm të situatave në të cilat ekziston Konflikti i Interesit (instituti i përjashtimit)?</p>
--	--	---

		<p>11. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave/rregullave të brendshme për konfliktin e interesit?</p> <p>12. A parashikon rregullorja për menaxhimin e Konfliktit të Interesit sanksione për shkeljen e rregullave dhe cilat lloje sanksionesh parashikohen?</p> <p>13. A ka një trajnim të rregullt për mësuesit për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për zbatimin e rregullave për konfliktin e interesit?</p> <p>14. A ekziston një procedurë publike për paraqitjen e ankesave për procedurën/rezultatet e provimit?</p> <p>15. A ekziston një sistem për mbikëqyrje mbi zbatimin e procedurës për ankesa?</p> <p>16. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në provime (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së sinjalizuesit)?</p> <p>17. A përmban procedura e informimit detyrimin e përgatitjes së raporteve për numrin, llojet dhe rezultatet e informuesve (statistikat e ankesave për informuesit dhe rezultatet e tyre)?</p> <p>18. A janë publike këto raporte?</p>
--	--	---



		<p>19. A ka një politikë që njeh dhe menaxhon favoret seksuale si rreziqe korrupsioni?</p> <p>20. A ka një politikë publike që trajton ngacmimin seksual?</p> <p>21. A ka ndonjë trajnim kundër korrupsionit dhe integritetit që përfshin adresimin e rreziqeve të korrupsionit në fushën e provimeve të studentëve?</p> <p>22. A përfshin ky trajnim trajtimin e favoreve seksuale si një formë korrupsioni?</p>
--	--	---

### 3,2. Fusha: Punimet shkencore dhe studentët

Procesi	Rreziku nga korrupsioni	Pyetje
<p><b>Punimet e studentëve (ese, seminare dhe punime të tjera me shkrim të studentëve gjatë studimit si pjesë e provimeve)</b></p>	<p><b>Mashtrimi:</b> paraqitja e punimeve të studentëve që janë shkruar nga dikush tjetër (<i>shkrim-fantazmë</i>).</p> <p><b>Plagjiatura:</b> përdorimi i punimeve të dikujt tjetër si punim personal pa kredituar burimin/ pa dhënë citimin e duhur (duke shmangur respektimin e rregullave të së drejtës së autorit dhe pronës intelektuale).</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. A është e detyrueshme për të kontrolluar/verifikuar nëse punimet e dorëzuara janë shkruar nga studentët që i kanë dorëzuar ato (për shembull, diskutim i detyrueshëm me gojë mbi punimet e dorëzuara me shkrim që mund të konfirmojnë se studenti e ka shkruar vërtet punën)?</li> <li>2. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për mësuesit/mentorët që të bëjnë kontrollin e vërtetimit të punimeve të paraqitura nga studentët?</li> <li>3. A është e detyrueshme që mësuesit/mentorët të shkruajnë një raport mbi punimet e paraqitura me shkrim të studentëve për të konfirmuar vërtetimin e tyre dhe për të përshkruar procesin e kontrollit të vërtetimit?</li> <li>4. A është e detyrueshme për të publikuar të gjitha punimet e studentëve që pranohen, rishikohen dhe vlerësohen?</li> <li>5. A ekziston një sistem për të raportuar një dyshim për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet e studentëve?</li> <li>6. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për hetimin e raportit kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet e studentëve?</li> </ol>

		<p>7. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të raportit hetimor të procedurës kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet e studentëve?</p> <p>8. A përmban detyrimin e përgatitjes së raporteve për numrin, llojet dhe rezultatet e rasteve (statistikat e rasteve dhe rezultatet e tyre), procedura për hetimin e raportit kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet e studentëve?</p> <p>9. A janë publike këto raporte?</p> <p>10. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në punimet e studentëve (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p> <p>11. A ka një trajnim të përshtatur për integritetin akademik për studentët dhe mësuesit/mentorët?</p>
<p><b>Punimi përfundimtar i studentëve, teza e magjistraturës dhe doktoraturës (punimet e studentëve që kërkohen për marrjen e një niveli të caktuar diplome)</b></p>	<p><b>Mashtrimi:</b> paraqitja e punimeve të fundit të studentëve që janë shkruar nga dikush tjetër (<i>shkrim-fantazmë</i>).</p> <p><b>Plagjiatura:</b> përdorimi i punimeve të dikujt tjetër si punim personal pa kredituar burimin/ pa dhënë citimin e duhur (duke shmangur respektimin e rregullave të së drejtës së autorit dhe pronës intelektuale).</p>	<p>1. A ekziston një softuer për të kontrolluar plagjiaturën?</p> <p>2. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike me shkrim për përdorimin e softuerit për të kontrolluar plagjiaturën (rregullore, udhëzime dhe të ngjashme)?</p> <p>3. A është e detyrueshme që mësuesit/mentorët të shkruajnë një raport mbi punimet e paraqitura përfundimtare të studentëve për të konfirmuar vërtetimin e tyre dhe për të përshkruar procesin e kontrollit të vërtetimit?</p>

		<p>4. A është e detyrueshme për të publikuar të gjitha punimet përfundimtare të studentëve që pranohen, rishikohen dhe vlerësohen?</p> <p>5. A publikohet raporti i mësuesve/mentorëve për kontrollin e vërtetimit (gjatë rishikimit të punimeve apo pasi punimet përfundimtare janë pranuar, rishikuar dhe vlerësuar)?</p> <p>6. A ekziston një sistem për të raportuar një dyshim për mashtrim dhe plagjiaturë në punimin përfundimtar të studentëve?</p> <p>7. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për hetimin e raportit kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimin përfundimtar të studentëve?</p> <p>8. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të raportit hetimor të procedurës kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimin përfundimtar të studentëve?</p> <p>9. A përmban detyrimin e përgatitjes së raporteve për numrin, llojet dhe rezultatet e rasteve (statistikat e rasteve dhe rezultatet e tyre), procedura për hetimin e raportit kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimin përfundimtar të studentëve?</p> <p>10. A janë publike këto raporte?</p> <p>11. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në punimin përfundimtar (raportimi i korrupsionit</p>
--	--	---

		<p>përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p> <p>12. A ka një trajnim të përshtatur për integritetin akademik për studentët dhe mësuesit/mentorët?</p>
<p><b>Punimet Shkencore (punimet e profesorëve/shkencëtarëve të botuara në revista dhe zakonisht që kërkohen për promovim dhe zhvillim të mëtejshëm në karrierë).</b></p>	<p><b>Mashtrimi:</b> paraqitja e punimeve shkencore që janë shkruar nga dikush tjetër (<i>shkrim-fantazmë</i>).</p> <p><b>Plagjiatura:</b> përdorimi i punimeve të dikujt tjetër si punim personal pa kredituar burimin/ pa dhënë citimin e duhur (duke shmangur respektimin e rregullave të së drejtës së autorit dhe pronës intelektuale). përfitime të ndryshme.</p> <p><b>Konflikti i interesit:</b> autori i veprës shkencore dhe recensuesi i veprës janë në konflikt interesi</p>	<p>1. A ekziston një softuer për të kontrolluar plagjiaturën në punimet shkencore?</p> <p>2. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike me shkrim për përdorimin e softuerit për të kontrolluar plagjiaturën e punimeve shkencore (rregullore, udhëzime dhe të ngjashme)?</p> <p>3. A ekziston një sistem për deklarimin e interesave private dhe për menaxhimin e mëtejshëm të situatave në të cilat ekziston Konflikti i Interesit ndërmjet autorëve dhe recensuesve (instituti i përjashtimit)?</p> <p>4. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave/rregullave për Konfliktin e Interesit ndërmjet autorëve dhe recensuesve?</p> <p>5. A parashikon rregullorja për menaxhimin e Konfliktit të Interesit ndërmjet autorëve dhe recensuesve sanksione për shkeljen e rregullave dhe cilat lloje sanksionesh parashikohen?</p> <p>6. A ekziston një praktikë e nënshkrimit të një mohimi të integritetit akademik si nga autorët ashtu edhe nga recensuesit se puna shkencore është vepër origjinale, autentike?</p>

		<p>7. A publikohet një mohim i integritetit akademik me punime shkencore?</p> <p>8. A ekziston një sistem për të raportuar një dyshim për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet shkencore?</p> <p>9. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për hetimin e raporteve kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet shkencore?</p> <p>10. A përmban detyrimin e përgatitjes së raporteve për numrin, llojet dhe rezultatet e rasteve (statistikat e rasteve dhe rezultatet e tyre), procedura për hetimin e raportit kur ekziston dyshimi për mashtrim dhe plagjiaturë në punimet shkencore?</p> <p>11. A janë publike këto raporte?</p> <p>12. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në punimet shkencore (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p>
--	--	---

### 3,3. Fusha: Menaxhimi i Stafit të Mësimdhënies

Procesi	Rreziku nga korrupsioni	Pyetje
<p><b>Punësimi i stafit të mësimdhënies</b></p>	<p><b>Favorizimi</b> – situata e dhënies së një trajtimi të padrejtë preferencial ndaj një kandidati në kurriz të kandidatëve të tjerë</p> <p><b>Nepotizmi dhe Kronizmi</b> – situata të favorizimit të të afërmeve ose miqve për shkak të marrëdhënieve të tyre dhe jo për shkak të cilësive të tyre.</p> <p><b>Patronazhi Politik</b> – ndikimi i partive politike në punësimin e stafit të mësimdhënies</p> <p><b>Ryshfeti</b> - zhvatja ose marrja e rryshfetit për të ndikuar në vendimet e punësimit</p> <p><b>Favoret seksuale</b> - zhvatje e favoreve seksuale në këmbim të punësimit</p>	<p>1. A shpallen paraprakisht pozicionet e lira për stafin e mësimdhënies?</p> <p>2. A është i mundur punësimi i stafit të mësimdhënies pa një proces konkurrues dhe si janë këto opsione të kufizuara, të mirë-dokumentuara, të arsyetuara dhe të mbikëqyrura?</p> <p>3. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për punësimin e stafit të mësimdhënës?</p> <p>4. A përfshin procedura për punësimin e stafit të mësimdhënies kritere të qarta dhe të detajuara për përzgjedhjen?</p> <p>5. A kanë të drejtë të apelojnë aplikantët e pasuksesshëm?</p> <p>6. A ekziston një sistem për mbikëqyrje mbi zbatimin e procedurës së punësimit?</p> <p>7. A ekziston një rregullore e brendshme publike për menaxhimin e Konfliktit të Interesit, që është e zbatueshme për</p>

		<p>situatat e konfliktit të interesit në procesin e punësimit të stafit të mësimdhënies?</p> <p>8. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave/rregullave të brendshme për konfliktin e interesit?</p> <p>9. A parashikon rregullorja për menaxhimin e Konfliktit të Interesit në procesin e punësimit të stafit të mësimdhënies sanksione për shkeljen e rregullave dhe cilat lloje sanksionesh parashikohen?</p> <p>10. A mbahet i gjithë informacioni konfidencial përpara procesit të përzgjedhjes?</p> <p>11. A plotësohen menjëherë vendet e lira në mënyrë që periudhat gjatë të cilave punonjësit marrin përsipër detyra më të larta të mos zgjaten padrejtësisht, në dëm të aplikantëve të tjerë të mundshëm?</p> <p>12. A verifikohen detajet mbi kualifikimet e aplikantëve me dokumentacion origjinal apo kopje të vërtetuara?</p> <p>13. A janë të dokumentuara arsyet nëse aplikantët nuk janë përzgjedhur në listën e përfshirë ose nuk janë intervistuar?</p> <p>14. A janë të dokumentuara dhe të mbajtura në dosje vendimet e përzgjedhjes?</p> <p>15. A janë publike vendimet e përzgjedhjes?</p>
--	--	--



		<p>16. A i nënshtrohen auditimeve të rregullta vendimet për punësimin e stafit të mësimdhënies?</p> <p>17. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në procesin e punësimit të stafit të mësimdhënies (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p> <p>18. A ka një politikë që njeh dhe menaxhon favoreve seksuale si rrezik korrupsioni?</p> <p>19. A ka një politikë publike që trajton ngacmimin seksual?</p> <p>20. A ka ndonjë trajnim kundër korrupsionit dhe integritetit që përfshin adresimin e rreziqeve të korrupsionit në procesin e punësimit të stafit të mësimdhënies?</p> <p>21. A përfshin ky trajnim trajtimin e favoreve seksuale si një formë korrupsioni?</p>
<p><b>Emërimi në pozitat drejtuese në institucionet e arsimit të lartë – dekanë, zëvendës dekanë, shefa të departamenteve, etj.<sup>29</sup></b></p>	<p><b>Patronazhi Politik</b> – situata e shpërblimit të profesorëve të veçantë për mbështetje politike/elektorale</p> <p><b>Ndikimi politik në punë</b></p> <p><b>Nepotizmi dhe Kronizmi</b> – situata të favorizimit të të afërmeve ose miqve për</p>	<p>1. A shpallen paraprakisht pozicionet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë?</p> <p>2. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për emërim në pozitat drejtuese në institucionin e arsimit të lartë me kritere për emërimin?</p>

<sup>29</sup> Këto pyetje mund të jenë të rëndësishme edhe për proceset e emërimit në pozicione jo drejtuese, si anëtarësimi në stafin e projektit ose grupe të caktuara pune që shpërblehen.

	<p>shkak të marrëdhënieve të tyre dhe jo për shkak të cilësive të tyre.</p> <p><b>Favoret seksuale</b> - zhvatja e favoreve seksuale në këmbim të emërimit në poste drejtuese në institucionet e arsimit të lartë</p>	<p>3. A ekziston një sistem për mbikëqyrje mbi zbatimin e procedurës për emërim në pozitat drejtuese në institucionin e arsimit të lartë?</p> <p>4. A ekziston një rregullore e brendshme publike për menaxhimin e Konfliktit të Interesit, që është e zbatueshme për situatat e konfliktit të interesit në procesin e emërimit në pozicionet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë?</p> <p>5. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave/rregullave të brendshme për konfliktin e interesit?</p> <p>6. A parashikon rregullorja për menaxhimin e Konfliktit të Interesit në procesin e emërimit në pozicionet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë sanksione për shkeljen e rregullave dhe cilat lloje sanksionesh parashikohen?</p> <p>7. A janë publike vendimet për emërimet me shënime shpjeguese?</p> <p>8. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në procesin e emërimit në pozicionet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p> <p>9. A ka një politikë që njeh dhe menaxhon favoret seksuale si rrezik korrupsioni?</p> <p>10. A ka një politikë publike që trajton ngacmimin seksual?</p>
--	---	--

		<p>11. A ka ndonjë trajnim kundër korrupsionit dhe integritetit që përfshin adresimin e rreziqeve të korrupsionit në procesin e emërimit në pozicione drejtuese?</p> <p>12. A përfshin ky trajnim trajtimin e favoreve seksuale si një formë korrupsioni?</p>
<p><b>Puna shtesë e stafit të mësimdhënies</b></p>	<p><b>Mungesa</b> - mosparaqitja në punë në Institucionin e Arsimit të Lartë ose puna më pak nga sa kërkohet, ndërkohë që paguhet si me kohë të plotë.</p> <p><b>Abuzimi me burimet</b> – përdorimi i burimeve të Institucionit të Arsimit të Lartë – pajisje, hapësira, etj për përfitime të tjera biznesi, miqësore apo personale, duke përdorur kohën e paguar për të njëjtat qëllime.</p> <p><b>Konflikti i Interesit</b></p>	<p>1. A ekzistojnë kufizime dhe rregulla të qarta dhe publike për punën shtesë të stafit të mësimdhënies?</p> <p>2. A ekzistojnë kërkesa të qarta dhe publike për çdo punë shtesë të stafit të mësimdhënies, duke përfshirë informacionin mbi natyrën e punës shtesë të paguar ose të papaguar për palët e treta?</p> <p>3. Cili është kufizimi i qartë që ekziston për përdorimin e burimeve të institucioneve të arsimit të lartë për qëllime personale/punë shtesë?</p> <p>4. A ekziston një mekanizëm kontrolli i frekuentimit në punë të stafit të mësimdhënies (p.sh. caktimi i një personi për të kontrolluar praninë e stafit, ose përdorimi i sistemeve IT)?</p> <p>5. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe kufizimeve për punën shtesë të stafit të mësimdhënies?</p> <p>6. A ka rregulla publike për të treguar se në cilat raste profesorët i mbajnë mësimet e rregullta dhe në cilat raste stafi tjetër i mësimdhënies?</p>

		<p>7. A parashikon rregullorja për punë shtesë të stafit të mësimdhënies sanksione për shkeljen e rregullave dhe cilat lloje sanksionesh parashikohen?</p> <p>8. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në lidhje me punën shtesë të stafit të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p> <p>9. A ka një Kod Sjelljeje/Rregulla Sjelljeje për stafin e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë?</p> <p>10. A ka trajnime kundër korrupsionit dhe integritetit që përfshijnë zbatimin e Kodit të Sjelljes/Rregullave të Sjelljes për stafin e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë?</p>
--	--	--

### 3.4. Fusha: Akreditimi/lëshimi i lejeve për institucionet private të arsimit të lartë

Procesi	Rreziku nga korrupsioni	Pyetje
<b>Akreditimi fillestar i institucioneve private të arsimit të lartë<sup>30</sup></b>	<p><b>Ndikimi politik në procesin e akreditimit</b></p> <p><b>Mashtrimi në procesin e akreditimit</b></p> <p><b>Ryshfeti për të marrë certifikim ose akreditim të suksesshëm</b></p>	<p>1. A ekziston një procedurë e qartë dhe publike për akreditimin fillestar të institucioneve të arsimit të lartë?</p> <p>2. A përfshin procedura për akreditimin fillestar të institucioneve të arsimit të lartë standarde/kritere të qarta dhe të detajuara për akreditim sipas standardeve ndërkombëtare?</p>

<sup>30</sup> Pyetjet për akreditimin fillestar janë gjithashtu të rëndësishme për proceset e riakreditimit dhe të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

	<p><b>Konflikti i interesit i personave të përfshirë në procedurën e akreditimit</b></p>	<p>3. A përfshijnë standardet/kriteret për akreditim ekzistencën e mekanizmave të brendshëm për parandalimin e korrupsionit?</p> <p>4. A përfshijnë rregullat përkatëse për akreditimet fillestare të institucioneve të arsimit të lartë një ndarje të qartë të kompetencave midis organeve të ndryshme dhe garanci të pavarësisë në procesin e vendimmarrjes sipas standardeve ndërkombëtare?</p> <p>5. A ka rregulla që përmbajnë kushte dhe kriteret të qarta për emërimin/përzgjedhjen e anëtarëve të të gjitha organeve që marrin pjesë në akreditimin fillestar të institucioneve të arsimit të lartë, përfshirë drejtuesit e institucioneve kompetente për akreditim, recensues që vlerësojnë përmbushjen e standardeve, etj?</p> <p>6. A kanë të drejtë të apelojnë aplikantët e pasuksesshëm të akreditimit fillestar?</p> <p>7. A ekziston një sistem për mbikëqyrje mbi zbatimin e një procedure për akreditim fillestar?</p> <p>8. A ekziston një rregullore publike për menaxhimin e Konfliktit të Interesit për të gjithë personat e përfshirë në vlerësimin e përmbushjes së standardeve dhe vendimmarrjen për akreditimin fillestar të institucioneve të arsimit të lartë?</p> <p>9. A parashikon rregullorja për menaxhimin e Konfliktit të Interesit në procesin e akreditimit fillestar të institucioneve të</p>
--	--	---

		<p>arsimit të lartë sanksione për shkeljen e rregullave dhe cilat lloje sanksionesh parashikohen?</p> <p>10. A ekziston një sistem për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave/rregullave për konfliktin e interesit?</p> <p>11. A është publik informacioni për përzgjedhjen e recensuesve që vlerësojnë përmbushjen e standardeve për akreditim fillestar të institucioneve të arsimit të lartë?</p> <p>12. A ka trajnime të përshtatura për recensuesit për vlerësimin e standardeve për akreditim fillestar të institucioneve të arsimit të lartë në praktikë?</p> <p>13. A ekziston një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e punës së recensuesve që vlerësojnë përmbushjen e standardeve për akreditim fillestar të institucioneve të arsimit të lartë (d.m.th. kriteret për vlerësimin e punës së tyre)?</p> <p>14. A janë publike të gjitha vendimet që lidhen me akreditimin fillestar të institucioneve të arsimit të lartë?</p> <p>15. A ka një bazë të dhënash të krijuar me vlerësime të përputhshmërisë me standardet për çdo program të institucioneve të arsimit të lartë të akredituara?</p> <p>16. Nëse po, a përditësohet rregullisht kjo bazë të dhënash në dispozicion të publikut?</p>
--	--	--

		<p>17. A ka trajnime të përshtatura për etikën dhe konfliktin e interesit për menaxhimin dhe stafin e organeve kompetente për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë?</p> <p>18. A ka sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet e procedurave?</p> <p>19. A ka sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet e rregullave të tjera për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë?</p> <p>20. A ekziston një sistem sinjalizimi për raportimin e korrupsionit në lidhje me akreditimin fillestar të institucioneve të arsimit të lartë (raportimi i korrupsionit përmes kanaleve të sigurta me elementë të procedurave të mbrojtjes së informuesit)?</p>
--	--	--

